



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM
Nr. 178, datë 03.04.2024

PËR
MIRATIMIN E “KOMENTE DHE SUGJERIME MBI REZULTATET E
VLERËSIMIT PARAPRAK NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TË
KANDIDATËVE QË KANË APLIKUAR PËR PRANIMIN NË FORMIMIN
FILLESTAR PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQTAR, PËR VITIN AKADEMIK
2024-2025”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 85, pika 1 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 30, pika 4 e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarë dhe/ose për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2024-2025,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më

____.____.2024

**KOMENTE DHE SUGJERIME
MBI REZULTATET E VLERËSIMIT PARAPRAK NGA SHKOLLA E
MAGJISTRATURËS TË KANDIDATEVE QË KANË APLIKUAR PËR PRANIMIN
NË FORMIMIN FILLESTAR PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQAR, PËR
VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 31, datë 31.01.2024, të ndryshuar, ka përcaktuar ndër të tjera, edhe numrin e kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025.

Pas këtij vendimi, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës (në vijim SHM), në datë 01.02.2024, ka vendosur të publikojë thirrjen për kandidime për pranimin në formimin fillestar për magjistrat. Po ashtu, Këshilli Drejtues i SHM ka miratuar edhe përbërjen e Komisionit të Administrimit të Provimit. Në vendim është përcaktuar gjithashtu edhe perioda e regjistrimit për kandidatët në formimin fillestar, në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim Ligji “Për Statusin”).

Me anë të njoftimit publik janë informuar të gjithë të interesuarit për fillimin e procedurës së aplikimeve, periudhën gjatë të cilës SHM do të pranonte dhe mblidhte dokumentacionin e personave të interesuar, fazat e zhvillimit të provimit të pranimit, kriteret që duhet të plotësoheshin sipas rastit, të parashikuara në nenin 28 të Ligjit “Për Statusin”, si dhe në nenin 10 të Rregullores së Brendshme të SHM, si dhe për dokumentet që duhet të dorëzohen nga personat e interesuar, parashikuar në nenin 11 të Rregullores. Shkolla e Magjistraturës ka njoftuar se aplikimi do të bëhet nëpërmjet sistemit elektronik në platformën Sistemi i Menaxhimit të Veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës (SMVSHM) dhe një kopje e dokumentave të nevojshme për aplikim do të dorëzohen pranë sekretarisë së Shkollës së Magjistraturës.

Për gjatë periudhës 1 deri në 29 Shkurt 2024, Sekretaria Shkencore për Formimin Fillestar pranë SHM ka pranuar aplikimet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e pranimit. Gjatë periudhës së regjistrimit, personat që kanë shprehur interesin dhe kanë kryer procedurat e regjistrimit pranë Shkollës së Magjistraturës si dhe kanë ngarkuar

dokumentacionin e tyre në platformë për të marrë pjesë në konkurs, janë në total 527 (pesëqind e njëzetë e shtatë) aplikantë për kandidatë për gjyqtar, prokuror dhe ndihmës ligjor. Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët për magistratë, Komisioni përkatës i ngritur për vlerësimin paraprak të dokumentacionit konstatoi se:

- 482 (katërqind e tetëdhjetë e dy) aplikantë kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga Shkolla e Magjistraturës për të aplikuar për kandidat për magistrat, profili gjyqtar
- 393 (treqind e nëntëdhjetë e tre) aplikantë janë kualifikuar pasi kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në ligj dhe Rregulloren e Brendshme të Shkollës.
- 89 (tetëdhjetë e nëntë) aplikantë janë skualifikuar për shkak se nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në ligj dhe Rregulloren e Brendshme të Shkollës.

Në vijim, raporti për rezultatet e vlerësimit paraprak, si dhe dokumentacioni i kandidatëve, i janë përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor¹, në respektim të pikës 4, të nenit 30, të Ligjit “Për Statusin”, sipas të cilit: “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse.”

Sipas dispozitës së mësipërme, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të japë komente ose kundërshtime, në lidhje me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve nga SHM, duke qenë kjo e fundit organi përgjegjës kompetent për të vendosur përfundimisht për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pra për kualifikimin ose përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në provimin e pranimit për në formimin fillestar.

¹ Me shkresën nr.332/2 prot., datë 18.03.2024, protokolluar në Këshill me nr. 1680 prot., datë 19.03.2024.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin që komentet dhe sugjerimet e tij t'i bazojë në ligj, pikërisht referuar kriterëve të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit “Për Statusin”², sipas të cilit: *“Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; c) ka përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose ka kryer me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj; ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi sipas shkronjës “c” të këtij neni, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal; dh) nuk është larguar nga detyra ose nuk i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; e) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.”*

Kriteret e mësipërme ligjore janë detajuar më tej në Rregulloren e Brendshme të SHM, ku në nenin 10 të saj³ përcaktohet se: *“..... 4. Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në Formimin Fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; c) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjisllacionit të arsimit të lartë, referuar nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë”. Diplomimi i tyre duhet të mbështetet në përfundimin e një programi sipas sistemit të Bolonjës 5-vjeçar, ose të jetë diplomuar si “Jurist” me një diplomë universitare të fituar para përshtatjes së studimeve sipas sistemit të Bolonjës në një program 4-vjeçar, e cila është ekuivalente me një Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, (DIND)”; d) ka notë mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë). Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj, parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të përkohet mesataren e tyre faktike; d/1)*

² Ndryshuar me ligjin nr. 50/2021, botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 14.05.2021. Hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të ligjit sipas nenit 21 të tij.

³ Ndryshuar me vendimin nr. 2, datë 29.1.2019, me vendimin nr.53, datë 28.12.2020, me vendimin nr. 8, datë 15.4.2021, me vendimin nr. 1 datë 27.01.2022, me vendimin nr. 3, datë 26.01.2023, shtuar me vendimin nr.41 datë 20.09.2023, ndryshuar pika “d” dhe “d/1) me vendimin nr.1 datë 29.01.2024.

Nota mesatare e përgjithshme del nga shumatorja e notave të të gjitha lëndëve të zhvilluara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve e pjesëtuar me numrin total të tyre. e) Shfuqizuar f) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë si jurist, pas diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare; g) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; h) nuk është larguar nga detyra ose nuk i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; i) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit; j) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; k) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete... ”

Referuar kritereve të pranimit në formimin fillestar, Këshilli i Lartë Gjyqësor konsideron bërjen e komenteve dhe sugjerimeve në lidhje me rezultatet e vlerësimit paraprak nga SHM për aplikantët që kanë kandiduar për magjistrat, profili gjyqtar, me qëllim që ato të vlerësohen nga SHM, në kuadër të miratimit të raportit të vlerësimit përfundimtar.

Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimin të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë që do të pranohen për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025, i ngritur me vendimin nr.55, datë 07.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të detyrimeve ligjore⁴, sipas praktikave të mëparshme, bën komente dhe sugjerime mbi raportin e vlerësimit paraprak të Shkollës së Magjistraturës.

Komisioni, referuar përcaktimeve në ligj dhe në akte të tjera nënligjore, ka vlerësuar që për përlllogaritjen e mesatares së përgjithshme dhe përlllogaritjen e përvojës profesionale, të merrren për bazë vlerësimet e marra përgjatë kryerjes/përfundimit/ diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, program studimi 4 vjeçar DIND, program studimi i integruar 5 vjeçar, dhe studime të ciklit të parë (Bachelor) së bashku me studimet e ciklit të dytë (Master Shkencor) të kryera të parat pas studimeve Bachelor.

Përmbushja e kriterit të përvojës profesionale, është përlllogaritur që nga data e përfundimit/ diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, program studimi 4 vjeçar DIND, program studimi i integruar 5 vjeçar, dhe studime të ciklit të parë (Bachelor) së bashku me studimet e ciklit të dytë (Master Shkencor), të kryera të parat pas studimeve Bachelor, deri në datën e mbylljes së aplikimeve.

Referuar këtij kuptimi, në lidhje me përcaktimet se cilat konsiderohen studime të plota universitare, nga ana e Komisionit janë bërë gjetjet si më poshtë:

I. Komente dhe sugjerime për aplikantët që janë vlerësuar paraprakisht se përmbushin kriteret ligjore

⁴ Neni 30 i Ligjit 96/2016 “Për Statusin” i ndryshuar

a) Kandidat të kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës, për të cilin sugjerohet rishikimi për shkak të mesatares së përgjithshme e cila rezulton nën 8.

1) Për aplikantin {...}⁵, për të cilin është vlerësuar se përmbush kriterin e mesatares së përgjithshme, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra rezulton që mesatarja për këtë kandidat është nën 8, pra e ndryshme nga ajo e evidentuar në rezultatet e vlerësimit paraprak.

2) Për aplikanten {...}⁶, për të cilën është vlerësuar se përmbush kriterin e mesatares së përgjithshme, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra rezulton që mesatarja për këtë kandidate është nën 8, pra e ndryshme nga ajo e evidentuar në rezultatet e vlerësimit paraprak.

b) Kandidatë të kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës për të cilin sugjerohet rishikimi i përvojës profesionale.

1) Për aplikantin {...}⁷ për të cilin është vlerësuar se përmbush përvojën profesionale parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “F”, e Rregullores së Brendshme të SHM, sugjerohet rivlerësimi i përvojës profesionale.

Referuar dokumentacionit të administruar në praktikën e aplikantit rezulton se, z. {...} ka përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë me kohë të plotë më datë 06.10.2020, Master i Shkencave në Drejtësi, në Drejtë Publike. Sipas librezës së punës rezulton se pas diplomimit në ciklin e dytë më kohë të plotë, është i punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në datat 15.02.2021-14.02.2022, si dhe nga data 01.04.2022 e në vijim, në pozicionin Doganier.

Në shkronjën “ç” të nenit 28 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.50/2021⁸, përcaktohet se çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi sipas shkronjës “c” të këtij neni në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare. Në zbatim të kësaj dispozite, referuar librezës së punës, aplikanti rezulton të ketë 2 vite 10 muaj dhe 28 ditë përvojë profesionale.

Sa më lart, për aplikantin, z. {...} për sa i përket përmbushjes së kriterit të përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, sipas nenit 10 pika 4, shkronja “F”, të Rregullores së Shkollës, sugjerohet rivlerësimi i përvojës profesionale

⁵ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.55

⁶ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.260

⁷ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.198

⁸ Botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 14.05.2021. Hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të ligjit sipas nenit 21 të tij.

dhe kohëzgjatjes së saj pasi, sipas përlllogaritjes në bazë të dokumenteve të depozituara nga aplikanti, ky fundit nuk rezulton që të ketë mbi tre vjet përvojë profesionale me kohë të plotë sikurse kërkohet nga neni 28, pika 1, shkronja “ç”, e Ligjit “Për Statusin”.

2) Për aplikanten {...} për të cilën është vlerësuar se përmbush përvojën profesionale parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “f”, e Rregullores së Brendshme të SHM, sugjerohet rivlerësimi i përvojës profesionale.

Referuar dokumentacionit të administruar në praktikën e aplikantes rezulton se znj. {...} ka përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë me kohë të plotë më datë 10.07.2019, Master i Shkencave në Drejtësi, në Drejtë Penale. Sipas librezës së punës rezulton e punësuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, në pozicionin sekretare gjyqësore, në datat 18.10.2019-31.12.2019. Gjithashtu ajo ka kryer stazhin 1-vjeçar të asistent avokatit nga datat 06.11.2019 deri në 06.11.2020. Më pas rezulton e punësuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pozicionin specialiste/jurist, në datat 04.01.2021-03.05.2021 dhe 26.01.2023-25.06.2023. Së fundmi, është punësuar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, në pozicionin Inspektore, nga data 30.05.2023 e në vijim.

Në shkronjën “ç” të nenit 28 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.50/2021⁹, përcaktohet se çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi sipas shkronjës “c” të këtij neni në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare. Në zbatim të kësaj dispozite, referuar librezës së punës, aplikantja rezulton të ketë 2 vite 6 muaj dhe 18 ditë përvojë profesionale.

Sa më lart, për aplikanten, **znj. {...}** për sa i përket përmbushjes së kriterit të përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, sipas nenit 10 pika 4, shkronja “f”, të Rregullores së Shkollës, sugjerohet rivlerësimi i përvojës profesionale dhe kohëzgjatjes së saj pasi, sipas përlllogaritjes në bazë të dokumenteve të depozituara nga aplikantja, kjo e fundit nuk rezulton që të ketë mbi tre vjet përvojë profesionale me kohë të plotë sikurse kërkohet nga neni 28, pika 1, shkronja “ç”, e Ligjit “Për Statusin”.

c) Kandidatë të kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës për të cilin sugjerohet rishikimi i kriterit të mospasjes masë disiplinore në fuqi.

1. Për aplikanten {...} në bazë të dokumentacionit të depozituar, rezulton se referuar vërtetimit nr. 2992. prot, datë 14.02.2024, të lëshuar nga punëdhënësi aktual Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, aplikantja ka masë disiplinore në fuqi “Pezullim nga e drejta e

⁹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 14.05.2021. Hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të ligjit sipas nenit 21 të tij.

ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3 mujore” dhënë nga Komisioni i Disiplinës me vendimin nr.637, datë 10.11.2023.

Për sa më sipër, sugjerojmë rishikimin e kriterit të mospasjes së masës disiplinore në fuqi.

d) *Kandidatë të kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës për të cilët mesatarja e përgjithshme rezulton 8.*

1. Aplikantët {...}¹⁰, {...}¹¹, {...}¹², {...}¹³ dhe {...}¹⁴ rezultojnë me notë mesatare të përgjithshme 8 (tetë).

II. Komente dhe sugjerime për aplikantët që janë vlerësuar paraprakisht se nuk përmbushin kriteret ligjore

a) *Gjetje mbi kandidatët që janë skualifikuar, të cilat nuk e ndryshojnë statusin e tyre si të skualifikuar.*

1. Për aplikantin {...}¹⁵ për të cilin është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e mesatares përgjithshme , parashikuar nga neni 10, pika 4, germa “d”, të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, pasi mesatarja e përgjithshme rezulton në masën 7.91. si dhe nuk përmbush kriterin e vjetërsisë në punë si Jurist pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve në Drejtësi , parashikuar në nenin 28 germa” c” të ligjit nr 96/2016 për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe nenin 10, pika 4 germa “f” e rregullores së brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra rezulton që mesatarja për këtë kandidat është mbi 8

2. Për aplikanten {...}¹⁶ për të cilën është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e vjetërsisë në punë si jurist pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve në drejtësi, parashikuar në nenin 28, germa “c”, të ligjit Nr, 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 10, pika 4, germa “f” e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, pasi rezulton se aplikantja ka 1 vite e 5 muaj eksperiencë pune si jurist pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve në drejtësi, .sugjerohet rivlerësimi i mesatares, pasi nga përlllogaritjet e bëra rezulton që mesatarja për këtë kandidate është nën 8.

3. Për aplikanten {...}¹⁷ për të cilën është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e mesatares së përgjithshme dhe përvojën profesionale si jurist, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronjat “d” dhe “f”, e Rregullores së Brendshme të SHM, sugjerohet rivlerësimi i përvojës profesionale për aplikanten, pasi rezulton mbi 3 vite.

¹⁰ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.29

¹¹ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.63

¹² Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.232

¹³ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.250

¹⁴ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.370

¹⁵ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.80 (kandidatw për gjyqtarë të skualifikuar)

¹⁶ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.29 (kandidatw për gjyqtarë të skualifikuar)

¹⁷ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.16

3) Për aplikanten {...}¹⁸ për të cilën është vendosur skualifikimi pasi në regjistrat e Shkollës së Magjistraturës rezultoi që znj. Bruçi ka ndjekur Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës në 2019-2020 në profilin ndihmës ligjor dhe është diplomuar në përfundim të saj në këtë profil. Bazuar në aktmarrëveshjen e lidhur mes Shkollës së Magjistraturës dhe aplikantes, parashikuar në aneksin 7/2 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, në nenin 4 të saj parashikohet shprehimisht se: “Kandidati për këshilltar dhe ndihmës ligjor nuk mund të konkurrojë pasi ka përfunduar me sukses Programin e Formimit Fillestar në një Program tjetër Fillestar në Shkollën e Magjistraturës”. Pra kandidatja skualifikohet referuar tabelës së skualifikimeve. (me numër rendor 40). Ndërkohë që aplikantja rezultoi e renditur njëkohësisht edhe në listën e kandidatëve të kualifikuar (me numër rendor 162). Në këto kushte sugjerojmë që aplikantja {...} të hiqet nga tabela e kandidatëve kualifikuar.

b) Gjetje mbi kandidatët e skualifikuar, të cilët e ndryshojnë statusin e tyre si të skualifikuar.

1. Për aplikanten {...}¹⁹, për të cilën është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e parashikuar në nenin 28, germa “dh”, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pasi në dokumentacionin e dorëzuar, në librezën e punës, aplikantja ka një shënim “larguar nga detyra” Sugjerojmë rivlerësimin e këtij kriteri sepse ky shënim nuk mund të konsiderohet si masë disiplinore. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga aplikantja, nuk rezultoi të ketë marrë apo të ketë në fuqi masë disiplinore.

Sipas librezës së punës, rezultoi se aplikantja ka qenë e punësuar pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, në pozicionin specialiste, nga datat 09.06.2008-11.08.2008 dhe në kategorinë e shkakut të largimit nga puna, aplikantja ka një shënim “larguar nga detyra”. Në vijim rezultoi se aplikantja ka qenë sërish e punësuar pranë këtij institucioni nga data 18.08.2008 (vetëm 7 ditë më pas) deri në datën 20.02.2010, dhe sërish në shkakun e largimit është shënim “larguar nga detyra”. Ky shënim nuk mund të konsiderohet si masë disiplinore në kuptim të nenit 28, shkronja “dh” e ligjit nr. 96/2016 pasi nuk është specifikuar që largimi nga detyra ka ardhur si pasojë e kryerjes së një shkelje disiplinore. Për më tepër që edhe pas shënimit “largim nga detyra” aplikantja rezultoi e punësuar sërish në të njëjtin institucion vetëm 7 ditë më pas. Sa më sipër, sugjerojmë t’i kërkohej informacion Institucionit në të cilin ka qenë e punësuar znj. {...}, lidhur me shënimin në librezën e saj të punës.

2. Për aplikantin {...}²⁰ i cili është skualifikuar pasi nuk përmbush kriterin e vjetërsisë në punë si jurist pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve në drejtësi, parashikuar në nenin 28, germa “c”, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 10, pika 4, germa “f” e Rregullores së Brendshme të Shkollës së

¹⁸ Me numër rendor të listës emërore SHM të kualifikuar nr.162, dhe listës të skualifikuar nr.40

¹⁹ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.76

²⁰ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.9

Magjistraturës, pasi rezulton se aplikanti nuk e ka eksperiencën e punës si jurist pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve në drejtësi, sugjerojmë rishikimin e dokumentacionit. Referuar dokumentit Letër Rekomandimit me nr. 398 prot., datë 04.02.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, dega doganore Rinas, z. {...} është punonjës i Doganës Rinas në pozicionin Doganier. Gjithashtu, në bazë të Vërtetimit nr. {...}, datë 05.02.2024 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, z. {...}{...} ushtron funksionin si Përgjegjës Zyre/Turni, Sektori Operacional/Terminal, Dega Doganore Rinas. Referuar rregullores së brendshme “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Degëve Doganore”, miratuar me Urdhrin nr. {...}, datë 07.05.2018 të Ministrit të Financave, dhe konkretisht Pjesa 2, neni 12, pika 7, “Kompetencat kryesore të **Përgjegjës Zyre** të Përpunimit të Anijeve/Tragetëve/Kontenierëve/Terminali Bregdetar Vlorë/**Terminali aeroport**, janë:....-Monitoron dhe shqyrton dokumentacionin e e Anijeve/Avionëve që po përpunohen dhe **kontrollon zbatimin e ligjshmërisë** në klasifikimin, origjinën, vlerësimin dhe kontrollin fizik të mallrave, mjeteve të transportit dhe të udhëtarëve.Sjellim në vëmendje se në listën e përcjellë nga ana e SHM, rezulton i kualifikuar për të marrë pjesë në provimin e pranimit për në formimin fillestar aplikanti {...}²¹ cili në bazë të Vërtetimit nr. {...}prot., datë 07.02.2024, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, rezulton i punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Sektori Operacional/Terminal, Dega Doganore Rinas, me funksion Doganier.

**KOMISIONI I PËRKOHSHËM PËR VERIFIKIMIN E KANDIDATËVE PËR NË
PROVIMIN E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR NË
SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS TË KANDIDATËVE PËR KANCELAR
DHE/OSE NDIHMËS LIGJOR, PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025**

²¹ Me numër rendor të listës emërore të SHM nr.58